



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1148/3 prot.

Tiranë, më 15. 11. 2023

V E N D I M

Nr. 232, datë 15. 11. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 237, datë 30.10.2023, të S. Ç., ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, bindjeve politike dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Tiranë² dhe Bashkisë Tiranë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

S. Ç., në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit parashtron ndër të tjera se është banor i Njesisë Administrative Nr. 4, Tiranë. Në vitin 1992, në anë të banesës së tij ka ndërtuar një shtesë e cila ka shërbyer si objekt banimi. Më datë 05.10.2022, përmes shkresës Nr. 8361 prot., është njoftuar nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, për dorëzimin e dokumentacionit që ai disponon lidhur me shtesën e bërë në anë të banesës së tij. Përmes shkresës datë 12.10.2022, ankuesi i është drejtuar IMT Tiranë duke i vënë në dijeni se për këtë objekt informal ka kryer procedurën e vetëdeklarimit pranë Zyrës së Urbanistikës të Njesisë së Qeverisjes Vendore Nr. 4 Tiranë, më datë 08.09.2006 dhe që nga ai moment edhe pse ka kërkuar ta legalizojë nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Sipas ankuesit, në vitin 2000, fqinji ka ndërtuar gjithashtu një objekt informal në krah të shtesës së tij dhe gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2011 e ka legalizuar. Gjithashtu edhe banorë të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta me të, i kanë legalizuar objektet informale të ndërtuara ndër vite,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën IMT Tiranë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

ndërsa atij nuk i është dhënë asnjë përgjigje nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës prej rreth 17 vitesh.

Më datë 20.10.2023, ankuesi thekson se i është prishur objekti informal pavarësisht kërkesave të shumta drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Avokatit të Popullit dhe IMT Tiranë.

Sa më sipër, ankuesi parashton se: *“Nga letrat e shkëmbyera me institucionet e sipërmendura, nuk kam marrë asnjë të dhënë/informacion konkret. Pas shumë letrave për përgjigje (me tejkallim afatesh ligjore) që prej muajit maj të këtij viti, inxhinierë të Drejtorisë Vendore Tirana Veri erdhën dhe bënë matjet/fotografitë por që prej asaj dite nuk kam marrë asnjë informacion lidhur me legalizimin e objektit shtesë anësore që posedoja deri më sot.*

Sot jam para faktit të prishjes së një shtese e cila deri në moment të fundit ka qenë në proces legalizimi. Ndodhur në këto kushte, jo vetëm vërej një mosveprim nga ana institucionale, një tejkallim të afateve ligjore procedurale, duke mos respektuar procesin e rregullt ligjor, por edhe ndihem i diskriminuar institucionalisht për mos trajtim të barabartë. Sot jam para një fakti të një trajtimi diskriminues pasi shtesa e fqinjit tim jo vetëm që është disa metra para meje (plani i rehabilitimit prek atë më parë), por është legalizuar dhe sot nuk është prishur.”

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të racës, ngjyrës, bindjeve politike dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Tiranë dhe Bashkisë Tiranë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dha akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua subjektit ankues me shkresën nr. 1148/2 prot., datë 31.10.2023, ku u kërkuar informacioni i mëposhtëm: *“...Duke qenë se shpjegimet dhe dokumentacioni i depozituar prej jush, në ankesën e bërë pranë Zyrës së Komisionerit janë të paplota e të paqarta, lidhur me shkaqet dhe me pretendimet kundrejt Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Tiranë dhe Bashkisë Tiranë, bazuar në kërkesat e nenit 33, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ju lutem dërgoni sqarimet përkatëse, parashtrime dhe dokumentacion lidhur me:*

- *Pretendimin tuaj lidhur me secilin prej subjekteve ndaj të cilëve keni ngritur pretendime për diskriminim. Pra, cili është veprimi apo mosveprimi i secilit subjekt ndaj të cilit keni ngritur pretendim diskriminimi dhe lidhjen me shkakun e pretenduar.*
- *Sqarime, fakte e prova që lidhen me shkaqet e pretenduara të diskriminimit. Pra, për secilin shkak diskriminimi të pretenduar (racë, etni, bindje politike dhe gjendje ekonomike), të vihen në dispozicion prova, fakte apo argumenta, përmes të cilave të*

provohet që ju mbartni secilin shkak prej tyre dhe të sqarohet se si kanë ndikuar këto shkaqe në situatën diskriminuese të pretenduar.”.

Në përfundim të kërkesës së sipërcituar, Komisioneri kërkoi që informacioni i nevojshëm për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës të vihet në dispozicion brenda datës 10.11.2023.

Në përgjigje sa më sipër, S. Ç., pavarësisht faktit që mori dijeni⁴ mbi shkresën e Komisionerit, nuk vuri në dispozicion të shqyrtimit të çështjes asnjë informacion përsa iu kërkua përmes shkresës nr. 1148/2 prot., datë 31.10.2023.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar⁵, në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12, parashikon: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;...”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata

⁴ Referuar Lajmërim Marrjes me Nr. Serie: RR 526 490 804 AA, ankuesi ka marrë dijeni më datë 02.11.2023.

⁵ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁶. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Mbështetur në nenin 32/1/a, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, për një nga shkaqet e mbrojtura, siç parashikohet në këtë ligj.

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji. Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Neni 1, i ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, parashikon mbrojtje nga diskriminimi për një listë të hapur shkaqesh. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i mbrojtur. Për sa më sipër, shkakut i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit dhe si i tillë, para pranimit për shqyrtim të ankesës së depozituar nga ankuesit, duhet vërtetuar së pari ligjshmëria e tij, si dhe së dyti duhet mbështetur provueshmëria e tij. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të racës, etnisë, bindjeve politike dhe gjendjes ekonomike, para pranimit

⁶ Neni 1, i ligjit 10221/2010 *‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’*, i ndryshuar citon se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

për shqyrtim të ankesës së depozituar nga ankuesi, duhen vërtetuar dhe duhet mbështetur provueshmëria e tyre. Në rastin konkret, ankuesi nuk ka depozituar asnjë provë apo fakt për të provuar nëse mbart shkaqet e pretenduara si dhe sa i përket formës dhe mënyrës se si kanë marrë dijëni subjektet ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën mbi shkaqet e pretenduara.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete. Shkak i diskriminimit në vetvete lidhet me një karakteristikë personale të subjektit ankues, e cila përbën pikënisje për reagimin e padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj tij. Subjekti ankues ka vënë në dukje se është diskriminuar për sa i përket, veprimeve apo mosveprimeve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, IMT Tiranë dhe Bashkisë Tiranë, por nuk ka provuar dhe argumentuar se sjellja diskriminuese ka ardhur si rezultat i një karakteristike personale apo shkaqeve të pretenduara prej tij.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilin subjekti ankues nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se ç) ...nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja ç), nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 237, datë 30.10.2023, të S. Ç., ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, bindjeve politike dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Tiranë dhe

Bashkisë Tiranë, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca, ngjyra, bindjet politike dhe gjendja ekonomike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)